



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 28
Prishtinë, më 28 korrik 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË JASHTZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 28 KORRIK 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 77 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Gjendja e aktuale në pjesën veriore të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi që ta marrë fjalën.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, **Hashim Thaçi**, informacionin mbi gjendjen aktuale në pjesën veriore të Republikës së Kosovës e paraqiti në fillim të mbledhjes së mëparshme.

Në vazhdim, Kryeministri tha se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ai personalisht do të jenë aktiv në këtë debat për gjendjen në veri.

Qeveria e Republikës së Kosovës, çdo rezolutë, të cilën do ta nxjerrë Kuvendi, do ta respektojë në përpikëri.

Ai i informoi deputetët e Kuvendit se sot do të mbahet mbledhja e Këshillit të Sigurimit në Nju Jork. Ministri i Jashtëm, zoti Enver Hoxha, është rrugës për në Nju Jork dhe do ta prezantojë qëndrimin e shtetit të Kosovës për situatën e re, në të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i respektojë në përpikëri obligimet kushtetuese dhe ligjore.

Kryetari ftoi kryetarin e GP të PDK-së që para deputetëve të paraqesë arsyetimin për pikën e propozuar për këtë mbledhje.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, paraqiti një projektrezolutë prej shtatë pikash. Me këtë projektrezolutë Kuvendi: mbështetë Qeverinë e Republikës së Kosovës për vendosjen e rendit dhe të ligjit në tërë territorin e Republikës; kërkon nga Qeveria që me të gjitha mjetet e saj kushtetuese dhe ligjore ta ruaj tërësinë territoriale të vendit; të respektohen masat e reciprocitetit me Serbinë në të gjitha pikat doganore; fton Bashkësinë Ndërkombëtare që të përkrah institucionet e vendit për vendosjen e rendit dhe ligjit në gjithë territorin e vendit; bënë thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa asnjë dallim, që t'i respektojnë vendimet e institucioneve të vendit dhe ta ruajnë qetësinë dhe rendin kushtetues.

Ai kërkoi nga grupet e tjera parlamentare që të angazhohen në plotësimin e kësaj projektrezolute, të cilën duhet ta miratojë Kuvendi.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se kanë ndjekur me shqetësim të thellë ngjarjet në veri të vendit, ku është rrezikuar rëndë gjendja e sigurisë. I vlerësojmë si kriminale dhe të papranueshme të gjitha veprimet e bandave serbe të nxitura nga institucionet e Serbisë dhe strukturat ilegale serbe në veri. Grupi Parlamentar i LDK-së dënon ashpër sulmin ndaj pikave kufitare në veri dhe djegien e tyre nga bandat serbe.

U bënë thirrje strukturave ndërkombëtare të sigurisë, të pranishme në Kosovë, që të përmbushin mandatet e tyre në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ne inkurajojmë institucionet tona vendore në angazhimin e tyre që t'i koordinojnë dhe të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nga prezenca ndërkombëtare

e sigurisë në shtetin tonë, veçmas nga KFOR-i, si garant i fuqishëm i sigurisë në Republikën e Kosovës.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se më 24 mars të vitit 2008, i kanë rekomanduar Qeverisë së Kosovës që, përveç tjerash, ta dërgojë Policinë e Kosovës dhe njësitë speciale të saj në pjesën veriore të Kosovës, për ta vënë nën kontroll atë territor të Kosovës, për ta vendosur rendin dhe ligjin dhe për ta shtrirë sovranitetin në tërë territorin e Republikës.

Ai propozoi që Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera t’i marrin këto veprime:

Së pari, Presidentja e vendit duhet të shpallë gjendje të jashtëzakonshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës; së dyti, të ndërpritet menjëherë dhe zyrtarisht procesi i bisedimeve me Republikën e Serbisë dhe të iniciohet sa më shpejt aktivizimi i resurseve qytetare dhe institucionale për mbrojtjen e Kosovës; së treti, Kosova duhet ta ketë situatën emergjente dhe ta thellojë bashkëpunimin me Republikën e Shqipërisë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me shtetet e BE-së që na kanë njohur dhe me Turqinë për strategjinë e ushtrimit të autoritetit të Republikës së Kosovës në tërë shtetin tonë; së katërti, Republika e Kosovës, menjëherë, duhet t’i fillojë diskutimet me Brukselin për përfundimin e misionit të EULEX-it në Kosovë dhe ta ridefinojë këtë prani të ndërkombëtare në Kosovë, nga misioni me fuqi ekzekutive dhe me imunitet ndaj ligjit, në misione mbështetëse për zhvillim të qëndrueshëm, demokraci dhe drejtësi; së pesti, që Kuvendi i Kosovës, në seancën e sotme, bashkë me Qeverinë ta diskutojnë strategjinë e marrjes së kontrollit në veri të vendit.

Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se kanë një interesim për të pasur rend dhe ligj dhe zbatim të Kushtetutës në veriun e Kosovës.

Veprim i Qeverisë së Kosovës u përkrah edhe nga institucionet e tjera të Kosovës, nga qytetarët dhe nga të gjithë ata që donë prosperitetin e Kosovës, zbatimin e Kushtetutës dhe vënien e rendit dhe ligjit edhe në atë pjesë të territorit të Kosovës. Por, dërgimi i njësiteve speciale në veriun e Kosovës dhe tërheqja e menjëhershme e tyre, rezultoi me të dhënat që i kemi tani: rënien e Heroit të Kosovës, Enver Zymberi, djegien e pikës 1 dhe tendencën për djegien e pikës doganore 31, kemi plagosjen e disa policëve atje dhe kemi prezencën e instrumenteve institucionale të Serbisë në veriun e Kosovës.

Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, që së bashku me instancat ndërkombëtare, sidomos me KFOR-in që ka mision mbrojtjen e kufirit dhe ruajtjen e rendit dhe të ligjit, që në veriun e Kosovës të ketë liri të lëvizjes, të ketë veprim institucional dhe të ketë funksionim normal të jetës së lirë të qytetarëve. Jo vetëm pikat doganore, jo vetëm policia, jo vetëm njësitet speciale, por komplet institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës duhet të kenë programet e tyre për Veriun e Kosovës, në mënyrë që Kosova të administrohet dhe të qeveriset si vend sovran.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se përkrahin veprimet e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Kosovës. Angazhohemi që institucionet tona të jenë të vendosura në veprimet e tyre kundër bandave kriminale serbe dhe t'i demonstrohet qartë Beogradit se Kosova nuk do të lejojë asnjë ndërhyrje në çështjet e saj të brendshme. Kërkojmë nga Qeveria të bashkëpunojë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me BE-në dhe me NATO-n për vendosjen e rendit dhe ligjit dhe të kushtetutshmërisë në pjesën veriore të Kosovës.

Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar 6+, tha se me vëmendje kanë përcjell ngjarjet në veri të Kosovës dhe dënojnë aktet e dhunës që kanë ndodhur atje. I japin mbështetje të plotë Qeverisë dhe institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës që ta sigurojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Ftojme përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, përgjegjës për fushën e sigurisë, të angazhohen maksimalisht për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në Republikën e Kosovës.

Opinione dhe sugjerime lidhur me gjendjen aktuale dhe zhvillimin e ngjarjeve në veri të Kosovës dhanë këta deputetë: **Nait Hasani, Sabri Hamiti, Albin Kurti, Arsim Barjami, Lutfi Haziri, Rexhep Selimi, Shaip Muja, Alma Lama, Enis Kervan, Ramiz Lladrovci, Teuta Sahatqija, Flora Brovina, Liburn Aliu, Xhevahire Izmaaku, Anton Çuni, Emilija Rexhepi, Gëzim Kelmendi, Ganimete Musliu, Florin Krasniqi, Bekim Haxhiu, Sadri Ferati, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti, Afrim Hoti, Hamza Balje, Petar Miletqi dhe Berat Buzhala.** Diskutimet e plota të deputetëve janë pjesë përbërëse e transkriptimit.

Në fund të debatit, deputeti Adem Graboci, në emër të propozuesit të Mocionit, paraqiti tekstin e Rezolutës, për miratim.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	89,
Kundër-----	9,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash,

V E N D O S I

Duke u nisur nga neni 2.2 dhe 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga neni 6.1 i Rregullores së Kuvendit,

Duke nisur nga e drejta e institucioneve për ushtrimin e kontrollit efektiv në tërë territorin e Republikën e Kosovës,

Duke u nisur nga parimet bazë të dokumenteve ndërkombëtare për Kosovën,

Duke u nisur nga e drejta e shteteve sovrane për kontroll të kufijve të vet,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e datës 28 korrik 2011, nxjerr këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, mbështet të drejtën kushtetuese të institucioneve për ushtrimin e kontrollit të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të respektohen masat e reciprocitetit me Serbinë në të gjitha pikat doganore.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton bashkësinë ndërkombëtare për t'i përkrahur institucionet e vendit në vendosjen e rendit dhe ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës apelon te të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim, që ta ruajnë qetësinë, rendin kushtetues dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria të vazhdojë me angazhimin e saj për vendosjen e autoritetit kushtetues në pikat kufitare 1 dhe 31 dhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera për shtrirjen dhe ushtrimin e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Kryetari deklaroi të mbyllur punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale